


Ekskluzive

# Ekskluzive | Sherri për pronën në Rahovec përfundon me një person në pranga – Policia i gjen dy armë zjarri 44-vjeçarit



Sinjali.com

06 Gusht 2026 22:20



**Një mosmarrëveshje pronësore mes familjarëve në fshatin Xërxe të Rahovecit ka çuar në arrestimin e një 44-vjeçari, ndërsa gjatë hetimeve Policia ka sekuestruar edhe dy armë zjarri në pronësi të tij.**

Sinjali mëson se i dyshuari është **Përparim Kryeziu**, 44 vjeçar, ndërsa viktimat të rastit janë Lulzim Kryeziu, 39 vjeçar dhe Binak Kryeziu, 74 vjeçar.

Sipas burimeve, Policia ishte njoftuar mbrëmjen e 5 gushtit, rreth orës 21:30, për një incident që kishte ndodhur mes familjarëve për shkak të një kontesti pronësor.

Fillimisht, me autorizim të Prokurorit të Shtetit, ndaj Përparim Kryeziut u iniciua procedurë për veprën penale “Kanosje”, ndërsa atij iu caktua masa e ndalimit për 48 orë.

Gjatë zhvillimit të hetimeve, Policia siguroi informacione se i dyshuari posedonte armë zjarri. Pas marrjes së autorizimeve të nevojshme dhe bastisjes së pronës së tij, u sekuestruan:

- një pistoletë me leje valide, kalibër 9×19 mm, së bashku me dy karikatorë dhe 30 fishekë;
- një pistoletë e modifikuar, e përshtatur nga një pistoletë me gaz, pa numër serik, si dhe 20 fishekë të kalibrit 9 mm.

Pas sekuestrimit të armëve, ndaj të dyshuarit iu shtua edhe dyshimi për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Me urdhër të Prokurores së Shtetit, rasti është proceduar në procedurë të shpejtë, ndërsa hetimet janë në vazhdim.

**Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.**

***Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!***

***/GazetaSinjali/***

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



## Lajme

Zgjedhjet 2026  
Kosovë  
Shqipëri  
Rajon  
Diasporë  
Evropë  
Botë

## Aktualitet

Politikë  
Drejtësi  
Siguri  
Shëndetësi  
Arsim  
Sociale

## Hulumtime

Ekskluzive  
Profile  
Skandaloze

## Ekonomi

Prodhime Vendore  
Financa  
Biznes

## Sport

Botërori 2026  
Futboll  
Basketboll  
Sporte Luftarake  
Sporte të tjera

## Showbiz

Bota e Yjeve  
Modë & Stil  
Bukuri dhe kujdes  
Të tjera

## OP-ED

Analizë  
Kolumne  
Intervistë

## Jetë

Fitness  
Ushqime  
Travel  
Këshilla  
Receta  
Dieta  
Shëndeti

## Kulturë

Film  
Muzikë  
TV & Radio  
Libra  
Art & Dizajn  
Fotografi  
Histori

## Tech & Auto

Teknologji  
Automjete  
Telefona  
Internet  
Lojëra  
Aplikacione

## Fun

Qesharake  
Kuriozitete  
Kuize  
Fakte  
Të tjera